



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve / Prishtinë / Pristina
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 37.3, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 27.12.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. SALI GOLAJ** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje- LVV" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Agon Batusha.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Sali Golaj dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 27.12.2019, Nr.2008/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Agon Batusha pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes deputet në Kuvendin e Kosovës, nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rënditur, i cila është, z. Sali Golaj i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 27.12.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka